



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

**PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014**

**SESIONI I**

**VARIANTI B**

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

**Lënda: Gjeografi e thelluar**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

<b>Kërkesa</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>
<b>Pikët</b>							
<b>Kërkesa</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>13</b>	<b>14</b>
<b>Pikët</b>							
<b>Kërkesa</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>17</b>	<b>18</b>	<b>19</b>	<b>20</b>	
<b>Pikët</b>							

Totali i pikëve


**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2. ....Anëtar

1. Rajoni i specializuar në nxjerrjen e mineralit të plumbit e zinkut është: **1 pikë**
- A) Rajoni i Fushë - Kosovës  
B) Rajoni Veri-Verilindor  
C) Rajoni Perëndimor  
D) Rajoni Juglindor
2. Elementi më i rëndësishëm i identifikimit të një populli është: **1 pikë**
- A) zakonet  
B) tradita  
C) gjuha  
D) veshja
3. Romët dhe arumunët që jetojnë në Shqipëri konsiderohen si: **1 pikë**
- A) pakica kombëtare  
B) pakica kulturore  
C) grupe etnokulturore  
D) grupe kulturore – kombëtare
4. Gjuha kineze përfshihet në grupin gjuhësor: **1 pikë**
- A) semito –hamatik  
B) sino-tibetian  
C) indo-europian  
D) malajo-polinezian
5. Dita më e shkurtër në hemisferën jugore është në datën: **1 pikë**
- A) 21 mars  
B) 22 qershor  
C) 21 dhjetor  
D) 22 dhjetor
6. Një nga pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit është: **1 pikë**
- A) Llogaritja e kohës lokale  
B) Shmangia e trupave që lëvizin horizontalisht  
C) Formimi i stinëve  
D) Forma vezake e orbitës së Tokës
7. Duke u bazuar te figura e mëposhtme, cilët shtete janë më të predispozuar për të pasur konflikt lidhur me pasuritë natyrore që zotërojnë? **1 pikë**

- A) Shteti A dhe shteti D  
B) Shteti C dhe shteti D  
C) Shteti A dhe shteti B  
D) Shteti B dhe shteti C



8. Bujanovci është një nga krahinat e trevave shqiptare i cili ndodhet në përbërje të: **1 pikë**

- A) Serbisë  
B) Kosovës  
C) Malit të Zi  
D) ish R.J. të Maqedonisë

9. Shkëmbinjtë më të përhapur në trevat shqiptare janë ata: **1 pikë**

- A) proterozoikë  
B) paleozoikë  
C) mesozoikë  
D) kenozoikë

10. Bazuar në të dhënat e tabelës cili shtet ka jetëgjatësinë më të lartë? **1 pikë**

- A) Brazili  
B) Ekuadori  
C) Kolumbia  
D) Argjentina

Shteti	Popullsia nën 15 vjeç	Popullsia mbi 65 vjeç
Argjentina	26.8%	10.4%
Brazili	29.1%	5.3%
Kolumbia	32.2%	4.7%
Ekuadori	36.2%	4.4%

Struktura moshore, viti 2000

11. Analizoni tri nga veçoritë e zhvillimit ekonomik në Republikën e Shqipërisë pas viteve '90 të shek. XX. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
b) \_\_\_\_\_  
c) \_\_\_\_\_

12. Cili është trendi i fazës së pestë të tranzicionit demografik? Shkruani një shtet që ndodhet në këtë fazë. **2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

13. Analizoni ecurinë e piramidës moshore të mëposhtme duke nxjerrë përfundimet mbi: rritjen e popullsisë, moshën mesatare dhe peshën që zë grupmosha e tretë. Karakteristikë e cilave vendeve është kjo piramidë moshore? **4 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



14. Shkruani nga një karakteristikë për vendbanimet e periudhës së: **3 pikë**

- a) Antikitetit: \_\_\_\_\_  
b) Mesjetës: \_\_\_\_\_  
c) Komunizmit: \_\_\_\_\_

15. Shpjegoni elementët e një vale detare.

4 pikë

- a) \_\_\_\_\_  
 b) \_\_\_\_\_  
 c) \_\_\_\_\_  
 d) \_\_\_\_\_

16. Renditni tre nga provat e Alfred Vegener, në mbështetje të teorisë së tij mbi devijimin e kontinenteve.

3 pikë

- a) \_\_\_\_\_  
 b) \_\_\_\_\_  
 c) \_\_\_\_\_

17. Shkruani tri veçori fizike–gjeografike të rajonit të Evropës Veriore.

3 pikë

- a) \_\_\_\_\_  
 b) \_\_\_\_\_  
 c) \_\_\_\_\_


18. Shkruani tri veçori fiziko–gjeografike të rajonit të Azisë Jugore.

3 pikë

- a) \_\_\_\_\_  
 b) \_\_\_\_\_  
 c) \_\_\_\_\_

19. Ndërtoni profilin topografik të vijës së hequr AB në hartën topografike të dhënë.

3 pikë



20. Si e kuptoni shprehjen e Antoine de Saint – Exupery -“Ne nuk e trashëgojmë tokën nga paraardhësit tanë, ne e kemi marrë atë hua nga pasardhësit tanë“. A ka lidhje ajo me zhvillimin e qëndrueshëm? Argumentoni përgjigjen.

2 pikë

- \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_